

Përbledhja

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e interesit personal dhe politikës organizative mbi qëllimin për mashtrim, duke analizuar rolin e mekanizmave ndërmjetësues si arsyetimi moral dhe zhvendosja e përgjegjësisë. Studimi përdor një mostër prej 406 profesionistësh të fushës së kontabilitetit, financave dhe auditimit, të cilët kanë plotësuar një pyetësor të strukturuar. Modelimi i ekuacionit strukturor është realizuar përmes softuerit IBM AMOS ver. 26.

Rezultatet konfirmojnë se interesi personal ka një ndikim të ndjeshëm pozitiv në qëllimin për mashtrim, arsyetimin moral dhe zhvendosjen e përgjegjësisë. Individët me nivele të larta të interesit personal priren të arsyetojnë veprimet e tyre dhe të zhvendosin përgjegjësinë, duke rritur prirjen për sjellje mashtruese. Po ashtu, arsyetimi moral dhe zhvendosja e përgjegjësisë luajnë një rol të rëndësishëm ndërmjetësues, ku zhvendosja e përgjegjësisë shfaqet si mekanizmi më i fuqishëm ndërmjetësues krahasuar me arsyetimin moral. Nga ana tjetër, analiza tregon se politika organizative nuk ndikon ndjeshëm në qëllimin për mashtrim dhe zhvendosjen e përgjegjësisë, por ka një ndikim negativ në arsyetimin moral. Kjo sugjeron se politika organizative e rreptë mund të reduktojë arsyetimet morale të sjelljeve mashtruese.

Implikimet teorike të këtij studimi ndihmojnë në kuptimin më të thollë të faktorëve socio-psikologjikë që ndikojnë në qëllimet mashtruese të profesionistëve të kontabilitetit, financave dhe auditimit. Studimi ofron kontribut të rëndësishëm akademik duke analizuar një kontekst të pashqyrtuar më parë brenda territorit të Kosovës dhe duke theksuar nevojën për politika organizative që minimizojnë prirjet mashtruese përmes reduktimit të arsyetimeve morale dhe zhvendosjes së përgjegjësisë.

Nga perspektiva praktike, studimi sugjeron se firmat e kontabilitetit, auditimit dhe organizatat financiare duhet të zbatojnë masa që promovojnë përgjegjësinë individuale dhe reduktojnë nxitësit personalë që favorizojnë sjellje mashtruese. Kjo mund të realizohet përmes rritjes së transparencës, forcimit të mekanizmave mbikëqyrës dhe promovimit të një kulture organizative të bazuar në etikë dhe integritet.

Originaliteti i këtij studimi qëndron në analizimin e faktorit të interesit personal dhe politikës organizative si dhe rolin ndërmjetësues të arsyetimit moral dhe zhvendosjes së përgjegjësisë në

kontekstin e profesionistëve të kontabilitetit, financave dhe auditimit në Kosovë. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese duke adresuar një boshllëk teorik dhe praktik mbi ndërhyrjet që mund të ndihmojnë në reduktimin e qëllimeve mashtruese në organizata profesionale.

Fjalët kyçë: interesi personal, politika organizative, arsyetimi moral, zhvendosja e përgjegjësisë, qëllimi për mashtrim, kontabilitet, financa, auditim